

GJYKATA KOMUNALE KAÇANIK, si gjykatë civile e shkallës së parë, gjyqtari Riza Livoreka, si gjyqtar individual, me sekretaren juridike Azemine Berisha , punëtore e kësaj gjykate, në çështjen juridike të paditësit B.T. , nga Kaçaniku, të cilët sipas autorizimit e përfaqëson A. I. avokat nga Prishtina, kundër të paditurës K.S.I nga Prishtinë, të cilën e përfaqëson I. H. me autorizim, për çështjen kontestuese pagimi i rentës mujore, në seancën kryesore të mbajtur me dt.01.10.2012, në praninë e paditësit, të autorizuarit të tij dhe të autorizuarës së të paditurës, mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I MIRATOHET, në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit B.T., nga..., Komuna e Kaçanikut dhe **DETYROHET**, e paditura K.S.I. me seli në Prishtinë , që paditësit t'ia paguaj rentën mujore, siç vijon :

I/a. Për periudhën e kaluar prej dates 10.04.2008 e deri më 30.09.2012 ,shumën prej 5.724.14 € .

I/b .Për të ardhmën duke filluar nga data 01.10.2012 e tutje deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore për çdo muaj t'ia paguaj shumën prej 128.80 € ,e cila shumë mujore do të paguhet më së voni deri më datën 10.të muajit të ardhshëm apo shumën e kapitalizuar prej 23.873.50 €.

E paditura mund t'a paguaj rentën e kapitalizuar për periudhën e kaluar dhe për periudhën e ardhshme që arrin vlerën e përgjithshme prej 29.597.00 €

II DETYROHET, e paditura që paditësit t'ia paguaj shumat e gjykuara në pikën I/a dhe I/b me kamatë si për mjetet e afatizuara në bankë mbi një vit pa destinacion të caktuar.duke filluar prej dates 14.06.2012 e gjer në pagesën definitive, ashtu edhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 1.250.00 €, t'ia paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit në dorëzim, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

A r s y e t i m

Paditësi permes të autorizuarit të tij, si në padi edhe në seancat e mbajtura gjyqësore i ka propozuar gjykatës që këkesëpadinë t'a miratojë në tërësi si të bazuar dhe t'a detyrojë të paditurën që paditësit t'ia paguaj rentën mujore për shkak të zvogëlimit të aftësisë punuese,sepse paditësi këtë dëm e ka pësuar me fajin e të paditurës.

I autorizuari i paditësit ka theksuar se me nenin 2 të rregullit 3 për sigurimin e detyrueshëm të auto përgjegjësisë, limiti i lejueshmërisë së polisës së sigurimit për

kompensimin e demit është 300.000 € ,në rastin konkret paditësi M. B. nuk e ka tejkualuar shumën prej 100.000 € ,e cila shumë konsiderohet limit për një person ,ndërsa kur ka më tepër se një person të lënduar në aksident atëherë ekziston shuma e përgjithshme prej 300.000 € ,e me kusht që asnjëri nga ta mos t'a kalojë limitin prej 100.000 € ,nga këto baza i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta miratojë në tërësi si të bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura përmes të autorizuarës së saj si në përgjigje në padi ashtu edhe gjatë seancave të mbajtura gjyqësore ,kërkesëpadinë e paditësit e ka kontestuar në tërësi si të pabazuar si për nga baza ashtu edhe për nga lartësia ,duke theksuar se kjo çështje juridike e kompensimit të demit është gjykuar nga kjo gjykatë për të gjitha format e demit kështu është kaluar limiti i përgjegjësisë që rrjedh nga polisa e sigurimit të detyrueshëm.

Meqenëse kemi të bëjmë me të njëjtin aksident në të cilin ka qenë i përfshirë paditësi e për të cilin rast janë zhvilluar dy procese gjyqësore paralelisht të pësura në të njëjtin aksident ,shumat e gjykuara e kanë tejkualuar limitin e përgjegjësisë i cili limit është në shumë prej 100.000 € , e duke u bazuar në rregullin 3 mbi ndryshimin e rregullit për sigurimin e detyrueshëm të auto përgjegjësisë,ku thuhet se shuma e përmbledhur për të gjitha automjetet është 100.000 € ,nga kjo na rezulton se KS. I. i ka kryer të gjitha obligimet kundrejt pales së dëmtuar për të gjitha kategoritë e demit, i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzojë si të pabazuar.

Shpenzimet nuk i ka kërkuar.

Gjykata për ta vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike në këtë çështje juridike me propozimin e palëve ndërgjyqësore e zhvilloi procedurën e provave me:u lexua aktgjykimi C.nr.85/08 prej dt. 11.12.2008, Përgjigjja në padi e dt.17.05.2012,Kopjet nga rregulli 3 ,Mendimi i ekspertëve dr. V. B. Konstatimi radiologjik, Fletëlëshimet me epikrizë me numër 146/2008 dhe 2855,Raporti i ambulancës Condor ,Raporti specialistik i dt.03.11.2011, Raportet specialistike në 5 kopje Super ekspertiza e dt.03.08.2012,Ekspertiza e aktuarit, Diploma e paditësit ,Çertifikata e qendrës për punë sociale,Vërtetimi i dt. 12.09.2012, Pa pyetje dhe me vërejtje.

Pas analizimit të provave në tërësi dhe të sëcilës veq e veq si dhe konform nenit 8 të LPK-së dhe bindjes së lire të gjykatës, Gjykata lidhur me këtë çështje kontestimore juridiko civile vërtetoi këtë gjendje faktike:

Aksidenti i komunikacionit ka ndodhur më dt. 10.04.2008, në këtë aksident paditësi ka pësuar lëndime trupore :Frakturë të pjesës temporo-parietale të kafkës, Hematomë (mbledhje e gjakut) në regjionin fronto-temporal,fracture zigomatiko-maksillare të anës së djathë, gjakëderdhje nga veshi i djathë, psarlizë e nervit facial të djathë , logophtalmus, aerocefali ,fracture e kllavikullës së majtë ,ndrydhje të mushkrive ,e si pasojë e këtij aksidenti tek paditësi është zvogëluar aktiviteti i punës në shkallë prej

35 %, (për shkak të dhimbjes së kokës ,harresës së shpeshtë ,mungesës së koncentrimit , si dhe dopsisë të anësive të majtë (dorës dhe këmbës së majtë) si dhe për shkak të tharjes së syrit(mungon lotimi), për shka të dëmtimit të pyramidës në për të cilën kalon nervi facial,e gjithë kjo pa fajin e paditësit e me përgjegjësinë e të siguruarit të të paditurës.

a) aksidenti i komunikacionit ka ndodhur me dt. 10 prill 2008 ,këtë fakt gjykata e vërtetoi nga aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Kaçanik C.nr. 88/08, i dt. 11.12.2008 nga i cili vërtetohet se aksidenti ka ndodhur më datën 10.04.2008,në rrugën magjistrale Hani i Elezit-Ferizaj në vendin e quajtur “uji i nxehtë” në Kaçanik, është shkaktuar me fajin e drejtuesit të automjetit të markës VW... me targë të regjistrimit.. ,sepse nuk e ka përshtatur shpejtësinë e automjetit me kushtet e rrugës, të cilin fakt gjykata e vërtetoi nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Po ashtu këtë fakt gjykata e ka vërtetuar nga raporti i policisë së trafikut të dt.10.04.2008, vërtetohet se aksidenti në të cilin paditësi ka pësuar lëndime trupore, i cili ka ndodhur më dt.10.04.2008, në rrugën magjistrale Hani i Elezit-Ferizaj, në vendin e quajtur “Uji i nxehtë” në Kaçanik është shkaktuar me fajin e drejtuesit të automjetit të markës “VW”... me targë të regjistrimit..., e sipas këtij raporti deri te aksidenti ka ardhur kur vozitësi i.automjetit nuk e ka përshtatur me kushtet e rrugës .

b) se paditësi ka pësuar lëndime të rënda trupore me pasoja të përhershme, këtë fakt gjykata e vërtetoi nga mendimi i ekspertit Dr. B. B., i cili ka konstatuar se paditësi ka pësuar lëndime të rënda trupore me pasoja të përhershme, për shkak se ka pësuar Frakturë të pjesës temporo-parietale të kafkës, Hematomë (mbledhje e gjakut) në regjionin fronto-temporal,fracture zigomatiko-maksillare të anës së djathë, gjakëderdhje nga veshi i djathhtë, psarlizë e nervit facial të djathhtë , logophtalmus, aerocefali ,fracture e kllavikullës së majtë ,ndrydhje të mushkrive.

c) se tek paditësi për shkak të lëndimit i është zvogëluar aftësia punuese, këtë fakt gjykata e konstatoi nga superekspertiza mjekësore e përpiluar nga grupi i ekspertëve Dr.F. B., mjek-ligjorë Dr. A. A. nurokirurg dhe Dr.F. D. mjek-ligjorë , të cilët në mendimin me shkrim kanë konstatuar se tek paditësi aftësia për punë është zvogëluar për 35%, për punë fizike që kërkojnë angazhim ,koncentrim,qëndrim në këmbë ,drejtpeshim dhe force muskulore të mjaftueshme e cila shkallë e zvoglimit të aktivitetit punues është e përhershme si rrjedhojë e pengesave në mbajtjen e drejtë peeshimit ,marramendjes ,uljes së koncetrimit dhe zvoglimit të forces muskulore të anës së majtë të trupit , e të cilës super eskpertizë gjykata ia dha besimin dhe e mori për bazë me rastin e vendosjes, andaj gjykat në bazë të nenit 154,155,178,al 1dhe 188 të LMD-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata e miratoi kërkesëapdinë e paditësit në tërësi si të bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ,sepse rregulla 3 mbi ndryshimin e rregullit për sigurimin e detyrueshëm të auto përgjegjësisë e dates 25 Qershor 2004 në nenin 2 pika a për rastet e vdekjes, lëndimit trupor dhe dëmtimit të shëndetit ,është e paraparë se shumica e

përmbledhur për të gjitha automjetet është 300.000 € e në rastin konkret kjo shumë nuk është tejkaluar andaj gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata i analizoi theksimet e të autorizuarit të paditësit, i cili i propozoi gjykatës që ta miratojë kërkesëpadin e paditësit, e të cilave theksime Gjykata ia dha besimin dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, sepse paditësi këtë dëm e ka pësuar pa fajin e tij ,dhe me fajin e të siguruarit të të paditurës, andaj vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi .

Gjykata po ashtu i analizoi edhe theksimet e të autorizuarës së të paditurës, e cila i propozoi gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit t'a refuzojë në tërësi si të pabazuar sepse paditësit e kanë tejkaluar limitin e shumës prej 100.000 € mirëpo këto theksime gjykata i refuzoi si të pabazuara, sepse me rregullin 3 edhe atë me nenin 2 ,limiti nuk është në shumë prej 100.000 € ,por është në shumë prej 300.000 € për të gjitha automjetet e në rastin konkret paditësit nuk e kanë tejkaluar këtë shumë, andaj gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Meqenëse e paditura ka rënë në vonesë me kompensimin e demit ndaj paditësit ,Gjykata në bazë të nen.277 të LMD-së, e detyroi të paditurën që paditësit në shumat e gjykuara t'ia paguaj kamatën si për mjetet e deponuara në bankë pa destinacion të caktuar për më shumë se një vit edhe atë duke filluar nga data 02.06.2008. e deri në pagesën definitive.

Gjykata e detyroi palën e paditur që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 1.250 € , edhe atë shumën prej 78 € për përpilimin e padisë ,shumën prej 300 € për ekspertizën mjekësore ,shumën prej 150 € për ekspertizën e aktuarit , për shpenzimet paraprake shumën prej 484 € për 4 seanca gjyqësore shumën prej 238 për takes gjyqësore për padi dhe aktgjykim.t ,gjykata vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore e ka bazuar në nenin 452.1,453 dhe 449 të LPK-së

Nga sa u thekësua më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi .

GJYKATA KOMUNALE KAÇANIK

C .nr.92/10 prej dt.01.10.2012

GJYQTARI

Riza Livoreka

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e
Lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh
Nga dita e marrjes ,ankesa i paraqitet
Gjykatës së Qarkut në Prishtinë përmes
Kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme